

Abstrakti i temës:

Veprimet procedurale të gjykatës në Procedurë Kontestimore - Liberta Xhema

Procedura civile është pjesë e së drejtës pozitive dhe përfshin të gjitha rregullat juridike që udhëheqin realizimin e të drejtave subjektive që lindin nga marrëdhëniet juridiko-civile në jetën e përditshme. Procedura kontestimore, nga ana tjetër, është një komponent thelbësor i sistemit të drejtësisë, e cila përdoret për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes dy ose më shumë palëve në një proces gjyqësor. Kjo procedurë përbëhet nga një seri hapash dhe veprimesh që synojnë sigurimin e një procesi të drejtë dhe të paanshëm për të gjitha palët e përfshira

Procedura kontestimore është fazë e cila fillon me padinë e paditësit dhe përfundon me vendimin përfundimtar të nxjerrur nga gjykata, e që secila fazë e procedurës kontestimore është mbrojtja e të drejtave të palëve në procedurë si dhe ofrimi i sigurisë për një zgjidhje të drejtë dhe të qartë për palën. Ofrimi i mbrojtjes gjyqësore në kohë të arsyeshme, e rrit besimin e qytetarëve në Gjykatat tona dhe në të njëjtën kohë ofron zgjidhje për kontestet ndërmjet palëve në procedurë.

Qëllimi i këtij punimi paraqitet si nevojë e studimit më të thelluar të veprimeve procedurale të gjykatës në procedurën kontestimore, pasi që është një temë e rëndësishme për përdorimin praktik në kontestet civile. Vet procedura kontestimore paraqitet si rrugë e veprimit që ndiqet me rastin e dhënies së mbrojtjes gjyqësore për të drejtën konkrete subjektive, e procedurën në tërësi e përbëjnë veprimet procedurale të cilat i kryejnë subjektet e një procesi kontestimor. Të gjitha veprimet duke filluar nga paditësi, i padituri dhe gjykata e përbëjnë një tërësi të vetme pasi që të tre subjektet i lidh i njëjti qëllim.

Gjykata duhet ti kushtojë rëndësi të veçantë veprimeve procedurale të cilat i ndërmerr në procedurën kontestimore, duke pasur parasysh që nga kjo varet edhe rrjedha e procedurës dhe zgjidhja e kontestit, ku me vendimin e marrë, e realizon edhe mbrojtjen e kërkuar në rastin konkret.

Fjalë kyce:

Gjykata, Ligji për Procedurën Kontestimore (tutje LPK), aktgjykim, kompetencë etj.